



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.160, datë 16.06.2023

PËR

**“VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË ZONJËS NERTILA BREGU,  
KANDIDATE PËR MAGJISTRAT PROKURORE, E CILA DO TË  
DIPLOMOHET NGA SHKOLLA E MAGJISTRATURËS NË VITIN 2023”**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159 dhe 189 pika 1, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 32 dhe 35 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës për magjistrat prokurore zonjës Nertila Bregu, e cila do të diplomohet nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2023”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Relacionit të kandidatës për t’u emëruar Prokurore, zonjës Nertila Bregu, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të vlerësojë të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatës Nertila Bregu.
3. Lejimin e kandidatës Nertila Bregu të vijojë me procedurat e mëtejshme për emërimin e saj si prokurore.
4. Të njoftohet për këtë vendim zonja Nertila Bregu.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 16.06.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR  
Alfred Balla

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ANËTAR  
Nuriban Seiti

ANËTAR  
Elaida Goxhi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ANËTAR  
Zeqir Hoda

ANËTAR  
Mirela Bogdani

ANËTAR  
Arta Mandro

ANËTAR  
Ledina Riza

